

FJALA E DEPUTETIT AGRON GJEKMARKAJ

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do ta devijoj paksa diskursin e kësaj pike të rendit të ditës, sepse nga kjo sallë themelore e demokracisë dhe e debatit politik shqiptar, dua të falënderoj Atin e Shenjtë, papa Françeskun dhe Sekretarin e Shtetit, kardinalin Parolin, për ftesat dhe pritjen që na rezervuan, zonjës Lindita Nikolla, Kryetare e Parlamentit dhe mua, në cilësinë e zëvendëskryetarit. Jam i sigurt që në këtë homazh mirënjohjeje bashkoheni të gjithë, ju, të nderuar kolegë, e bashkë me ne i gjithë populli shqiptar.

Nuk mund të jem indiferent përballë një ngjarjeje të tillë, e cila nuk ka lidhje vetëm me personat që u nderuan si personazhe kalimtare, tejet kalimtare, të një historie të gjatë miqësie mes Vatikanit dhe Shqipërisë, por me vetë Shqipërinë. Nuk do të mjaftonte një komunikatë për shtyp, as një ilustrim fotografish për të përcjellë vëmendjen, respektin, afrinë e papa Françeskut, të Eminencës Parolin dhe krejt shtetit të Vatikanit për popullin tonë. Asgjë nuk ndodh rastësisht në marrëdhëniet mes vendeve, ka një traditë kushtëzuese, ka një element bashkëkohësie që ngjit, ka një projekt për të ardhmen që bashkon.

Në këtë kontekst, Ati i Shenjtë zgjodhi për të vizituar Shqipërinë si të parin vend evropian në vitin 2014 në itinerarin e vet si Pelegrin i Paqes, duke çmuar vllazërinë mes komuniteteve fetare në vendin tonë, harmoninë dhe mirëkuptimin që vjen nga thellësi e kohëve, si bazament solid dhe si shembull për një botë që trazohet. Po kaq nën profilet e martirëve të Kishës Katolike pati kaluar ai, si për t'iu përgjigjur thirrjes së tyre dhe të vetë kishës shqiptare në shekuj, për t'i folur epokës dhe qytetërimit tonë se sa gjak është derdhur, sa qëndresë është bërë në emër të Zotit, të identitetit dhe të lirisë.

Lutem për Shqipërinë dhe popullin shqiptar, tha Shenjtëria e Tij, duke sugjeruar që popujt, të cilët punojnë për progresin, për paqen, për standardet demokratike fitojnë gjithmonë. Po kaq i çmuar ishte në këshillën e tij, se duhet një politike njerëzore për njerëzit dhe për ndërtuar mbi vlerat më të mirat të humanizmit, dhe jo mbi egoizmin. Gjithashtu, i vëmendshëm e tejet i interesuar për të gjitha dinamikat shqiptare, ishte dhe kardinali Parolin, i cili revokoi miqësinë historike, kumtet që vijnë prej saj, mbështetjen e shtetit të Vatikanit dhe dëshirën që Shqipëria t'i bashkohet në të gjitha formatet familjes europiane, duke konservuar arritjet e saj më të mira të bashkëjetesës, por edhe në zhvillimin e demokracisë, pa bjerrur humanizmin.

Të nderuar kolegë,

Marrëdhëniet tona me Vatikanin e meritojnë një analizë historike, politike dhe kulturore. Në vitin 1968 shqiptarët e diasporës mblidheshin rreth papa Montinit, për të kujtuar 500-vjetorin e vdekjes së Mbretit Gjergj Kastriot dhe ai do u drejtohej atyre: “Bij fort të dashun shqiptarë. Po ju sjellim juve një mirësearchje të veçantë, mbasi qenkeni mbledhun për të kujtuem pesëqindvjetorin e Gjergji Kastriot Skanderbegut, fatosit të kombit t’uej e të krishtënimit, pranë kësaj Selije Apostulike, të cillën mund ta gjykoni si shtëpinë t’uej. Na po ju shohim më të kënaqun, sepse e dijmë se shpirti me të cilin ju e kujtoni ketë rasë asht shpirti i hershëm i fisit t’uej, i cili gjithë herë përmbi çdo interes ka vum vlerat e trashëgimisë, të besës, të nderës e të burrnisë”.

Tre papë nga viti 1443-1468 nuk ia kursyen ndihmën morale, ekonomike dhe politike prijësit të shqiptarëve, humanisti i madh Enea Silvio Piccolomini më shumë nga të gjithë. Pikërisht kur arbrit dukeshin se përjetonin shkretimin e madh, kur litarët e fundit që mbanin gjallë kujtesën gati po këputeshin, në vitin 1703, Papa Klementi me origjinë shqiptare shfaqet si ideues dhe mecenat i Kuvendit të Arbërit mbajtur në Mërqi të Lezhës. Kjo besëlidhje shpëtoi dhe rilidhi historinë tonë kombëtare. Kur je nën ata portikë, që nuk ndryshojnë në shekuj, është e pamundur të mos përpiqesh të imagjinosh, të kuptosh ku zbriti Skënderbeu, me kalorësit e tij.

Çfarë kumtesh nga Arbëria e përgjakur çoi në qytetin caput mundi? Në cilin korridor kaloi ai? Në cilat ganxha i vuri pelerinat e purpurta? Nën cilën relikë të Giottos apo Peruginos u ul ai? Deri ku e pritën dhe e përcollën mëkëmbësit e Shën Pjetrit? Mos në ato biseda të zymta lufte dhe

mbijetese u farkëtua përfundimisht identiteti evropian i shqiptarëve? Ajo formulë që gjeniu Kadare nxori si tharm të rrugëtimit tonë: “Shqiptarët ndërsa për veten luftuan, për Europën po kaq si mbrojtës u panë”? Po ashtu, në vitin 2018, në përvjetorin e 550-të Papa Françesku përsëriti mes shqiptarëve në Vatikan se: “Gjergj Kastrioti mbrojti me guxim vlerat shpirtërore dhe emrin e krishterë, aq sa të meritonte titullin “Atlet i Krishtit”.

Me veprat e tij, farkëtoi identitetin kulturor shqiptar, duke u bërë simbol i padiskutueshëm lidhjeje dhe bashkimi kombëtar”. Lufta 25-vjeçare dhe kujtimi i Kastriotit, mbeten si amanet i përjetshëm që Selia e Shenjtë të kujdesej për shqiptaret, të cilëve fati nuk u kurseu sfidat. Aty u strehua nga furitë e moteve thagma e gjuhës shqipe, “Meshari” i Gjon Buzukut. Ipeshkvi Pal Engjëlli e nisi lërimin e tokës së ashpër nga mospunimi me formulën: “Unte te paghesont premenit Atit et birit et spertit senit ”, një frazë hyjnore që shqipen e shpëtoi nga zhdukja. Pikërisht, këtë frazë të qëndisur i dhuruam papa Françeskut në emër të Kuvendit të Shqipërisë.

Në shtypshkronjat e shtetit që u ndërtua mbi një libër, Biblën, bëri librat e tij Pjetër Budi, ai që na kujton raportin me jetën duke na pyetur: “Ku janë ata pleq bujarë, që qenë përpara ne, e ata trima sqimatarë, të shpejtë si rrufe? ” Nën nevojat e kohës dhe zulmat e kujtimeve kardinalët financuan Pjetër Bogdanin me sibilat e tij, Frang Bardhin me apologjinë për Skënderbeun dhe fjalorin e një gjuhe që “bdarej e bastardhohej” nën sulmin otoman, që t’i flisnin shqip, në jetë të jetëve dheut të Arbërit. Po kaq me Nikollë Kazazin, dhe më vonë me shkollat e klerit katolik në Shkodër, Zadrimë e Mirditë, prej të cilave do dilnin rilindasit e mëdhenj me Fishtë, Mjedën e të tjerë.

Në procesin e pavarësisë dhe sidomos kur në Konferencën e Parisit kufijtë tanë rrezikoheshin të tkurrreshin, kur Korça e Gjirokastra lakmoheshin nga Greqia, me apelimin e Fishtës, Luigj Bumçit dhe Pal Dodës, Papa Benedikti XV u drejtohej fuqive të mëdha që ato dy qytete t’i mbeteshin Shqipërisë. Eqerem Çabej kultivues par excellence i dijeve të epërme, që në këtë Parlament duket se nuk u interesojnë shumë, e la të skalitur në çdo ndërgjegje intelektuale se: “Qëndrimi i ndërmjemë midis Perëndimit dhe Lindjes, i bashkuar me ruajtjen e ngulur të natyrës së vet etnike, i ka gdhendur Shqipërisë përgjithmonë fytyrën e saj të veçantë.

Këtë nuk ka mundur ta fshijë as sundimi turk. Kjo shprehet në krejt mënyrën e jetesës, në historinë dhe në historinë kishtare, në zakone dhe në poezi popullore dhe artistike të popullit shqiptar. Duhet theksuar me këtë rast, se Shqipëria ka qenë e orientuar më tepër nga Perëndimi sesa fqinjët e saj. Midis gjithë vendeve ballkanike, edhe Rumania, me gjithë idiomën roman të saj, e pa përjashtuar, Dalmacinë, pa dyshim Shqipëria është vendimi më i çelur për kulturën të perëndimore në rajon.” Me këtë vetëdije prelatët shqiptarë bënë qëndresë, që lidhja të mos ndërpritej me çmimin e gjakut, torturës, vdekjes, duke i dhënë kombit dhe kishës martirë të denjë për t’i ndenjtur në krah Pjetrit dhe Palit.

Nuk rrimë dot pa i kujtuar disa prej tyre, duke u hyrë në hak qindra të tjerëve që nuk i vëmë dot në listë: imzot Vinçens Prenushi, imzot Frano Gjini, at Benardin Palaj, dom Lazër Shantoja, Marie Tuci, padre Gjon Shllaku, padre Mati Prenushi, at Anton Harapi, dom Ndre Zadeja, at Çiprian Nika, e shumë të tjerë. Po kaq ata që epokat i kaluan burgjeve si at Donat Kurti, at Pjetër Meshkalla, at Marin Sirdani, at Zef Pllumi i konsakruar tashmë si “frati i kujtimeve” me veprën antropologjike e monumentale “Rrno vetëm për me tregue”. Edhe pse Perdja e Hekurt ishte e rëndë mbi ne, papa Gjon Pali, në vitin 1982, nga Puglia i lëshonte anatemën dhe paralajmëronte për rënien e saj diktaturën komuniste.

Në 32 vjet liri e pluralizëm shteti i Vatikanit është shfaqur në krah të Shqipërisë si askush tjetër. Papa Gjon Pali dhe papa Françesku vizituan Shqipërinë. Nënë Tereza, ajo që më shumë se kushdo, pas Shën Françeskut interpretoi doktrinën e Hyjit dhe atë të dashurisë (është e pamundur të flas, kur ministrat gjithë kohës bëjnë dërr - dërr pas shpinës time), u shpall shenjtoje, si momenti i dytë kulmor i marrëdhënies që vjen nga historia dhe punon për të. I bëj thirrje këtij Kuvendi dhe qeverisë shqiptare, ta shpallë Vatikanin partner strategjik si detyrim ndaj shekujve dhe si nevojë e shekujve që vijnë. Kjo më shumë për ne sesa për ata. Faleminderit!